



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.27 të Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ligjin nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, në takimin e mbajtur më.....miraton këtë:

RREGULLORE NR. / 2024
PËR EMËRIMIN E KRYEPROKURORIT TË SHTETIT DHE KRYEPROKURORËVE
TË PROKURORIVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e procedurës së përzgjedhjes dhe përfundimit të mandatit të Kryeprokurorit të Shtetit, Zëvendëskryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorëve, zëvendëskryeprokurorëve dhe udhëheqësve të departamenteve.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet nga të gjitha nivelet e sistemit prokurorial.

Neni 3
Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

“KPK”Këshilli Prokurorial i Kosovës;
“PSH”Prokurori i Shtetit;
“ZKPSH”Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;
“LKPK”Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës;

“KPSH”Kryeprokurori i Shtetit;
“PSRK”Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës;
“PA”Prokuroria e Apelit;
“PTH” Prokuroria Themelore;
“NJSHP”Njësitë për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë;
“KVPP”Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve;
“Aplikues”Prokurori që paraqet aplikacionin për pozitën e shpallur;
“Kandidati”Aplikuesi që plotëson kriteret e konkursit për të hyrë në garë për pozitën e shpallur;
“Paneli Vlerësues” ...Anëtarët prokurorë të Këshillit, të cilët bëjnë poentimin e kandidatëve, duke mos përfshirë anëtarët e përjashtuar nga procesi dhe anëtarët e Komisionit për Rishqyrtim;
“Komisioni për Rishqyrtim” Anëtarët e KPK-së, të cilët shqyrtojnë kundërshtimet e aplikuesve, respektivisht kandidatëve
“Ditë” Ditë pune;
“Sekretariati”Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
“Përzgjedhja”nënkupton procesin e propozimit, nominimit, emërimit dhe zgjedhjes.

Neni 4 Parimet

1. Procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, Zëvendëskryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorëve, zëvendëskryeprokurorëve dhe udhëheqësve të departamenteve bëhet në bazë një procesi objektiv, transparent, jodiskriminues dhe gjithëpërfshirës, të bazuar në meritokraci.

Neni 5 Kriteret ligjore

1. Kandidati për Kryeprokuror të Shtetit dhe Kryeprokuror duhet të plotësojë kriteret si në vijim:
 - 1.1 të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
 - 1.2 të mos jetë i dënuar për veprë penale, përjashtimisht veprave penale të kryera nga pakujdesia;
 - 1.3 të mos ketë aktakuzë të ngritur, përjashtimisht atyre të ngritura për vepra penale të kryera nga pakujdesia;
 - 1.4 të ketë vlerësim të dalluar apo të mirë të performancës në dy (2) vlerësimet e fundit të rregullta;

- 1.5 të tregojë dhe dëshmojë integritet të lartë dhe aftësi menaxheriale;
- 1.6 të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore, me përjashtim të qortimit apo vërejtjes jobpublike në pesë (5) vjetët e fundit.
2. Përveç kriterëve të parapara në paragrafin 1 të këtij neni, për të ushtruar funksionin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë, kandidati duhet të plotësojë edhe kriteret e veçanta si në vijim:
- 2.1. për të ushtruar funksionin si Kryeprokuror i Shtetit, kandidati duhet të jetë prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit apo të ketë së paku tetë (8) vjet përvojë pune si prokuror i shtetit, nga të cilat pesë (5) vjet si prokuror në Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Speciale, Departamentin për Krime të Rënda apo Departamentin për të Mitur.
- 2.2. për ta ushtruar funksionin si Kryeprokuror i Prokurorisë së Apelit, kandidati duhet të jetë prokuror në Prokurorinë e Apelit apo të ketë së paku shtatë (7) vjet përvojë pune si prokuror i shtetit, nga të cilat tri (3) vjet si prokuror në Departamentin për Krime të Rënda apo Departamentin për të Mitur;
- 2.3. për të ushtruar funksionin si Kryeprokuror i Prokurorisë Speciale, kandidati duhet të jetë prokuror në Prokurorinë Speciale apo të ketë së paku gjashtë (6) vjet përvojë pune si prokuror i shtetit, nga të cilat tre (3) vjet si prokuror në Departamentin për Krime të Rënda apo Departamentin për të Mitur dhe
- 2.4. për të ushtruar funksionin si Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore, kandidati duhet të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë pune si prokuror i shtetit.

KAPITULLI II

PROCEDURA E EMËRIMIT TË KRYEPROKURORIT TË SHTETIT DHE KRYEPROKURORËVE

Neni 6

Shpallja e konkursit për Kryeprokuror të Shtetit dhe kryeprokurorë

1. KPK-ja shpall konkurs për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit jo më vonë se 90 ditë para skadimit të mandatit të Kryeprokurorit aktual të Shtetit.
2. KPK-ja shpall konkurs për emërimin e kryeprokurorëve të prokurorive të tjera, jo më vonë sesa 60 ditë para skadimit të mandatit të kryeprokurorëve aktualë.

3. Në rastet kur pozita e KPSH-së dhe kryeprokurorëve të prokurorive të tjera mbetet e lirë para skadimit të mandatit të rregullt, konkursi do të hapet jo më vonë sesa 45 ditë.
4. KPK-ja merr vendim për shpalljen e konkursit. Konkursi përmban kriteret për emërimin e KPSH-së dhe kryeprokurorëve të prokurorive përkatëse dhe udhëzimin për aplikim.
5. Vendimi dhe shpallja e konkursit publikohet në faqen zyrtare të sistemit prokurorial dhe fizikisht në të gjitha ndërtesat e prokurorive. Shpallja bëhet në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.
6. Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes.
7. Nëse për pozitën për KPSH apo ndonjërin pozitë për kryeprokuror nuk pranohet asnjë aplikacion i vlefshëm, KPK-ja do të përsërisë konkursin vetëm për prokurorinë përkatëse, jo më vonë se 5 ditë pune.
8. **Anëtarët prokurorë të KPK-së, gjatë mandatit dhe dy vjet pas përfundimit të mandatit si anëtarë të KPK-së nuk mund të aplikojnë për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, Kryeprokurorit dhe Zëvendëskryeprokurorit.**

Neni 7

Aplikacioni dhe dokumentet përcjellëse

1. Kandidati duhet t'i dorëzojnë dokumentet si në vijim:
 - 1.1. Formulari për aplikim;
 - 1.2. Jetëshkrimin e tyre (CV);
 - 1.3. Konceptdokumentin për Kryeprokuror të Shtetit për menaxhimin e Prokurorisë së Shtetit, respektivisht Konceptdokumentin për Kryeprokuror për menaxhimin e prokurorisë përkatëse;
 - 1.4. Vetëvlerësimin dhe
 - 1.5. Dokumentet e tjera relevante për të dokumentuar përvojën e tyre, përfshirë rekomandimet nëse kanë.
2. Formularët e aplikacionit, konceptdokumentit dhe vetëvlerësimit janë të publikuara në faqen zyrtare të KPK-së dhe janë pjesë integrale të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Konfirmimi i statusit të kandidatit

1. Sekretariati do të rishikojë materialet e pranuar nga secili aplikues për të përcaktuar nëse kanë plotësuar kriteret e kërkuara me këtë rregullore për t'u konsideruar formalisht si kandidatë për pozitat përkatëse.
2. Sekretariati do t'i dorëzojë te paneli vlerësues për shqyrtim dhe konfirmim listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara.
3. Sekretariati do t'i dorëzojë panelit vlerësues edhe listën e aplikuesve, të cilët nuk plotësojnë kriteret e kërkuara së bashku me shpjegimin lidhur me atë se cilat kritere kanë dështuar t'i plotësojnë.
4. Pas konfirmimit nga paneli vlerësues, kandidatët dhe aplikuesit e pakualifikuar do të njoftohen me shkrim për vendimin.
5. Vendimi i panelit vlerësues mund të kundërshtohet në KPK brenda tri ditëve. Kundërshtimi duhet të përmbajë dëshmi që vërtetojnë se aplikuesi i plotëson kriteret për të qenë kandidat.
6. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatit dhe kundërshtimit me shkrim, KPK-ja merr vendim përfundimtar mbi statusin e tij, jo më vonë sesa 5 ditë pune.
7. Pas konfirmimit përfundimtar, KPK-ja njofton kandidatët të cilët plotësojnë kriteret dhe publikon listën përfundimtare.
8. Pas konfirmimit të statusit të kandidatit nga ana e Këshillit, Sekretariati obligohet që të publikojë konceptdokumentet e kandidatëve.

Neni 9

Përfundimi i anëtarëve të KPK-së

1. Cilido anëtar i KPK-së që ka marrëdhënie të afërt, familjare apo private me cilindo kandidat do të përjashtohet nga pjesëmarrja në proces.
2. Cilido anëtar i KPK-së që ka konflikt interesi ose që beson se nuk mund të marrë vendim të drejtë në vlerësimin e cilitdo kandidat do të terhiqet nga pjesëmarrja në proces për të gjithë kandidatët.

3. Cilido anëtar i KPK-së mund të propozojë përjashtimin e anëtarit tjetër me pretendimin për bazën për përjashtim sipas këtij neni.
4. Nëse ka kundërshtim lidhur me konfliktin e interesit, KPK-ja mund të kërkojë opinion nga Agjencia Kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit të anëtarit të KPK-së.
5. Lidhur me kërkesën për përjashtim vendos KPK-ja.

Neni 10 **Sjellja gjatë procesit**

1. Asnjëri nga anëtarët e KPK-së nuk do të komunikojë me cilindo kandidat lidhur me procesin e përzgjedhjes, përveç komunikimeve zyrtare. Cilido anëtar që gjendet në shkelje të kësaj rregulle do t'i nënshtrohet masave disiplinore.
2. Asnjë kandidat, anëtar i personelit apo anëtar i KPK-së nuk do të tentojë të ndikojë në anëtarët e tjerë të KPK-së rreth procesit të përzgjedhjes. Kushdo që gjendet në shkelje të kësaj rregulle do t'i nënshtrohet masave disiplinore.
3. Anëtarëve të KPK-së u kërkohet të raportojnë te Kryesuesi i KPK-së për çfarëdo tentimi nga cilido individ për të komunikuar me anëtarët lidhur me procesin e emërimit, për hetim të mëtutjeshëm.

Neni 11 **Dosja e kandidatit**

1. Sekretariati dhe NJSHPP-ja bëjnë mbështetjen administrative të procesit për emërim të KPSH-së dhe kryeprokuroreve.
2. Sekretariati dhe NJSHPP-ja do të përgatisin dosjet për secilin kandidat me të dhënat si në vijim:
 - 2.1. Dokumentet e dorëzuara nga kandidati, të kërkuara sipas konkursit;
 - 2.2. Vlerësimin vjetor nga ana e eprorit për kandidatin për tre (3) vjetët e fundit;
 - 2.3. Të dhënat nga KVPP-ja për performancën e kandidatit. Nëse një vlerësim i tillë mungon, atëherë KVPP-ja, në bazë të kërkesës së Kryesuesit do ta bëjë vlerësimin e atij kandidati në afat prej 15 ditësh;
 - 2.4. Të dhënat për masat disiplinore të shqiptuara në pesë (5) vjetët e fundit;
 - 2.5. Të dhënat statistikore për performancën e kandidatit në tri (3) vjetët e fundit;

- 2.6. Informacione të tjera nga burimet relevante, duke përfshirë burimet publike për të konfirmuar përshtatshmërinë e kandidatit për pozitën.

Neni 12

Paneli vlerësues dhe procedura e intervistimit

1. KPK-ja themelon Panelin vlerësues në përbërje nga Kryesuesi i KPK-së dhe katër (4) anëtarë, të zgjedhur me short, të paktën njeri nga të cilët duhet të jetë anëtar joprokuror. Paneli vlerësues kryesohet nga Kryesuesi i KPK-së.
2. Këshilli cakton edhe dy anëtarë rezervë, të cilët zgjidhen me short dhe nuk mund të jenë anëtar të Panelit për rishqyrtim.
3. Anëtarët e Panelit vlerësues do të zgjidhen me short, duke vënë në kuti emrat e anëtarëve të mbetur të KPK-së.
4. Anëtarëve të Panelit vlerësues do t'u sigurohen dosjet e kompletuara të kandidatëve në gjuhën e zgjedhjes së tyre, jo më vonë sesa 48 orë para intervistës.
5. Të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e kërkuara do t'i nënshtrohen intervistimit.
6. Për secilin kandidat do të ndahet kohë prej 45 deri në 60 minuta për intervistim.
7. Pyetjet standarde për të gjithë kandidatët do të përpilohen tri (3) orë para intervistës. Paneli vlerësues do të pajtohet për pyetjet para intervistës, me mundësinë e parashtrimit të pyetjeve shtesë varësisht nga çështjet specifike rreth kandidatit individual.
8. Kryesuesi i Panelit vlerësues do të udhëheqë intervistën dhe cilido anëtar tjetër ka mundësinë për të parashtruar pyetje shtesë.
9. Së bashku me ftesën për intervistim, kandidatët njoftohen me përbërjen e Panelit vlerësues dhe u jepet mundësia e paraqitjes së kundërshtimit ndaj përbërjes së Panelit vlerësues brenda tri (3) ditësh nga pranimi i ftesës. Kundërshtimi i paraqitet Panelit për rishqyrtim.
10. Në qoftë se Paneli për rishqyrtim gjen se vërejtja e kandidatit ndaj ndonjë anëtari të Panelit vlerësues është e arsyeshme, i propozon Kryesuesit të Panelit vlerësues që me short ta zëvendësojë anëtarin me ndonjërin nga anëtarët rezervë.

11. Intervista do të incizohet. Incizimi i intervistës mund t'i jepet Gjykatës për qëllim të procedurës së emërimit dhe të procedurës gjyqësore.
12. Paneli vlerësues do të bëjë poentimin e kandidatëve.

Neni 13 **Paneli për rishqyrtim**

1. KPK-ja do të themelojë Panelin për rishqyrtim për vleresimin e kundërshtimit të kandidatëve.
2. Paneli për rishqyrtim do të caktohet për secilin konkurs për pozitën e caktuar.
3. Paneli për rishqyrtim për procesin e caktuar për Kryeprokuror apo Kryeprokuror të Shtetit përbëhet nga tre (3) anëtarë të KPK-së.
4. Anëtarët e Panelit për rishqyrtim zgjidhen me short nga KPK-ja.
5. Anëtarët e Panelit për rishqyrtim nuk marrin pjesë në procesin e intervistimit.

Neni 14 **Kriteret për poentim**

1. Poentimi i kandidatëve do të bazohet në kriteret e përgjithshme, si në vijim:
 - 1.1 Konceptdokumenti dhe prezantimi i tij - deri në 30 pikë;
 - 1.2 Integritetin e kandidatit - deri në 20 pikë;
 - 1.3 Aftësitë udhëheqëse dhe menaxheriale - deri në 30 pikë;
 - 1.4 Njohuritë teknike dhe përvoja e nevojshme për ushtrim të funksionit - deri në 20 pikë.

Neni 15 **Procesi i poentimit**

1. Secili anëtar i Panelit vlerësues do të ketë kodin e veçantë dhe në mënyrë të pavarur dhe konfidenciale do të poentojë kandidatin menjëherë pas intervistimit të kandidatit.
2. Anëtari i Panelit vlerësues jep arsyetim për secilën kategori të poentimit të kandidatit.

3. Pas poentimit të kandidatit, të gjitha fletëpoentimet dorëzohen në Sekretariat, i cili është përgjegjës për llogaritjen e rezultatit përfundimtar për secilin kandidat.
4. Rezultati përfundimtar i poentimit për një kandidat do të përlllogaritet nga Sekretariati, duke mbledhur pikët e dhëna një kandidat nga secili anëtar i Panelit vlerësues dhe më pas duke e përpjesëtuar me numrin e anëtarëve të Panelit vlerësues.
5. Sekretariati do të rendisë kandidatët bazuar në rezultatet përfundimtare të poentimit nga paneli.
6. Veprimet nga paragrafët 3, 4 dhe 5 të këtij neni zbatohen nën mbikëqyrjen e Kryesuesit të Panelit vlerësues.
7. Anëtarët e Panelit vlerësues do të bëjnë poentimin e kandidatëve sipas kritereve të dhëna në nenin 13 të kësaj rregulloreje. Të gjitha dokumentet e dorëzuara nga kandidati, dokumentet e tjera nga dosja e kandidatit, informacionet e mbledhura për kandidatin dhe të gjitha informacionet e marra gjatë intervistës do të shërbejnë për poentimin e kritereve të përgjithshme për poentim të parapara me këtë rregullore.

Neni 16 **Njoftimi i kandidatëve**

1. Secili kandidat do të pranojë një kopje të vlerësimit të tyre, brenda pesë (5) ditëve nga dita e përfundimit të procesit të vlerësimit.
2. Njoftimi do të përmbajë:
 - 2.1. Poentimin përfundimtar nga të gjithë anëtarët e Panelit vlerësues, të anonimizuar dhe
 - 2.2. Poentimin individual, të anonimizuar, të dhënë nga secili anëtar i Panelit vlerësues, së bashku me arsyetimin për secilën kategori poentuese.
3. Njoftimin përfundimtar e bën Kryesuesi i Panelit vlerësues me mbështetje të Sekretariatit.

Neni 17 **Kundërshtimi i kandidatëve ndaj procesit të poentimit**

1. Cilido kandidat që kundërshton moszgjedhjen e tij/saj si kandidat përfundimtar për votim në KPK, ka të drejtë të paraqesë kundërshtim ndaj procesit të përzgjedhjes. Kundërshtimi i paraqitet Komisionit për rishqyrtim të KPK-së.

2. Kundërshtimi duhet të dorëzohet me shkrim jo më larg sesa 5 (pesë) ditë nga njoftimi.
3. Kundërshtimi duhet të përmbajë arsyet specifike, si në vijim:
 - 3.1. Për moszbatim të dispozitave të ligjit në aspektin procedural dhe material;
 - 3.2. Për moszbatim të dispozitave të kësaj rregulloreje;
 - 3.3. Poentimi është në kundërshtim me arsyetimin dhe
 - 3.4. Për shkaqe teknike.
4. Kundërshtimi nga kandidati duhet të mbështetet në prova.
5. Paneli për rishqyrtim shqyrton kundërshtimet për të përcaktuar nëse janë të bazuara dhe në rastin e rishqyrtimit, Paneli për rishqyrtim ka në dispozicion tërë dosjen e kandidatit duke përfshirë edhe audioincizimin.
6. Paneli për rishqyrtim në rast se gjen shkelje nga paragrafi 3 i këtij neni e kthen procesin në rivlerësim tek Paneli për vlerësim, respektivisht tek anëtari i Panelit për vlerësim, të cilit iu ka kundërshtuar vlerësimi.
7. Paneli për vlerësim e njofton kandidatin për rivlerësimin.
8. Kandidati që është i pakënaqur me rivlerësimin, i njëjti brenda tri (3) ditëve mund t'i drejtohet përsëri Panelit për rishqyrtim. Paneli për rishqyrtim e njofton KPK-në me kundërshtimin e kandidatit dhe i jep rekomandim konkret lidhur me kundërshtimin.
9. Nëse KPK-ja aprovon propozimin e Panelit për rishqyrtim dhe nëse ka shkelje e kthen procesin në rivlerësim tek Paneli për vlerësim, nëse KPK-ja vlerëson se nuk ka parregullsi merr vendim të kalohet në procesin e votimit.
10. Një kopje e vendimit për refuzim apo aprovim të kundërshtimit, sipas këtij neni, përfshirë arsyet për refuzim, i dorëzohet kandidatit.

Neni 18

Procesi i votimit

1. Paneli për vlerësim i rekomandon Këshillit Prokurorial të Kosovës dy kandidatët më të vlerësuar nga lista e kandidatëve për Kryeprokuror nëse kanë mbi 70% të poenave.

2. Në rastin kur kandidati i tretë ka poentim të njëjtë me kandidatin e dytë, i njëjti gjithashtu i rekomandohet KPK-së për votim.
3. Kandidati që fiton shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm zgjidhet kryeprokuror i prokurorisë përkatëse, ndërsa në rastin e KPSH-së, kandidati i propozohet Presidentit për emërim.
4. Në rast se në rundin e parë të votimit nuk merr shumicën e votave asnjëri nga kandidatët, atëherë dy kandidatët më të votuar nga Këshilli kalojnë në rundin e dytë të votimit. Në rast se kandidate i dytë dhe kandidati i tretë marrin numër të njëjtë të votave, mbahet një rund i veçantë i votimit ndërmjet tyre dhe kandidati i cili merr numrin më të madh të votave kalon në rundin e dytë të votimit.
5. Nëse edhe pas përsëritjes së votimit, asnjëri nga kandidatët nuk merr numrin e duhur të votave, procesi përmbillet dhe KPK-ja rishpall konkursin.
6. Të gjithë anëtarët e KPK-së do të shfrytëzojnë të drejtën e votës, me përjashtim të anëtarëve që janë përjashtuar duke u bazuar në nenin 9 të kësaj rregulloreje.
7. Nëse anëtari i Këshillit merr pjesë në takimin kur votohet për kandidatët dhe nuk voton për asnjërin nga kandidatët, kjo do të konsiderohet si abstenim që ka vlerë vetëm për kuorum.
8. KPK-ja në të gjitha rastet, sipas këtij neni, voton përmes votimit të fshehtë.
9. Të gjithë kandidatët që plotësojnë kushtet, sipas këtij neni, do të shënohen njëkohësisht në fletëvotim.
10. Anëtari i KPK-së mund të votojë vetëm për njërin kandidat në fletëvotim.
11. Nëse anëtari voton për dy apo më shumë kandidatë në fletëvotim, fletëvotimi do të konsiderohet i pavlefshëm. Nëse anëtari i Këshillit nuk voton për asnjërin kandidat konsiderohet se ka abstenuar.
12. Kandidati që fiton shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm zgjidhet kryeprokuror i prokurorisë përkatëse. Në rastin e KPSH-së, ai kandidat do të propozohet te Presidenti për emërim.

Neni 19
Kriteret e përgjithshme për Zëvendëskryeprokuror të Shtetit dhe
Zëvendëskryeprokuror

1. Për të ushtruar funksionin e Zëvendëskryeprokurorit të Shtetit dhe Zëvendëskryeprokurorit, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. të jetë prokuror me së paku katër (4) vjet përvojë pune në prokurorinë përkatëse;
 - 1.2. të mos ketë aktakuzë të ngritur, përjashtimisht atyre të ngritura për vepra penale të kryera nga pakujdesia;
 - 1.3. të mos jetë i dënuar për vepër penale, përjashtimisht veprave penale të kryera nga pakujdesia;
 - 1.4. të ketë vlerësim pozitiv të performancës në tre (3) vjetët e fundit;
 - 1.5. të tregojë dhe dëshmojë integritet të lartë dhe aftësi menaxheriale;
 - 1.6. të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore, me përjashtim të qortimit apo vërejtjes jopublike në pesë (5) vjetët e fundit.

Neni 20

Kriteret e përgjithshme për Udhëheqës të Departamentit

1. Për të ushtruar funksionin e Udhëheqësit të Departamentit, kandidati duhet t'i plotësojë kushtet si në vijim:
 1. të ketë së paku katër (4) vjet përvojë pune si prokuror;
 2. të mos ketë aktakuzë të ngritur, përjashtimisht atyre të ngritura për vepra penale të kryera nga pakujdesia;
 3. të mos jetë i dënuar për vepër penale, përjashtimisht veprave penale të kryera nga pakujdesia;
 4. të ketë vlerësim pozitiv të performancës në tre (3) vjetët e fundit;
 5. të tregojë dhe dëshmojë integritet të lartë dhe aftësi menaxheriale;
 6. të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore, me përjashtim të qortimit apo vërejtjes jopublike në pesë (5) vjetët e fundit;
 7. të ketë qenë i caktuar në periudhë prej së paku dy (2) vjet në atë departament.

Neni 21

Zgjedhja dhe mandati i Zëvendëskryeprokurorit të Shtetit, zëvendëskryeprokurorëve dhe udhëheqësve të departamenteve

1. Zëvendëskryeprokurori i Shtetit zgjidhet nga Këshilli, me propozim të Kryeprokurorit të Shtetit, për një mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një (1) mandat.
2. Zëvendëskryeprokurori zgjidhet nga Këshilli, me propozim të kryeprokurorit përkatës, për një mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një (1) mandat.

3. Udhëheqësit e departamenteve, të përcaktuar me këtë rregullore zgjidhen nga Këshilli në bazë të propozimit të kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse, për një mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një (1) mandat.
4. Para procesit të votimit, Kryesuesi i KPK-së obligon Sekretariatit të përgatisë një raport nëse kandidatit i propozuar plotëson kriteret e parapara ligjore.

Neni 22

Caktimi i Ushtruesit të Detyrës së Kryeprokurorit dhe udhëheqësve të departamenteve

1. Në qoftë se mandati i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse ka përfunduar në çfarëdo mënyre, KPK-ja merr vendim për caktimin e Ushtruesit të Detyrës.
2. KPK-ja do të caktojë Ushtruesin e Detyrës së Kryeprokurorit edhe në rastet kur nuk arrin që të zgjedhë kryeprokurorin e asaj prokurorie.
3. KPK-ja do të caktojë Ushtruesin e Detyrës së Kryeprokurorit, prokurorin i cili plotëson kriteret e përcaktuara me **nenin 5 të** kësaj rregulloreje.
4. **Bazuar në dispozitat tek paragrafi 3, këto kriteret vlejné edhe me rastin e caktimit të Ushtruesit të Detyrës së KPSH-së.**
5. KPK-ja me propozim të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore cakton Ushtruesin e Detyrës së Udhëheqësit se Departamentit të Përgjithshëm, Departamentit për të Mitur dhe Departamentit për Krime të Rënda në këtë prokurori.
6. Me propozim të kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse, KPK-ja cakton ushtruesit e detyrave të udhëheqësve të departamenteve edhe për prokuroritë e tjera.
7. Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse me rastin e propozimit të ushtruesve të detyrave të udhëheqësve të departamenteve duhet të ketë parasysh integritetin dhe performancën e përgjithshme të kandidatit të propozuar.
8. KPK-ja mund të refuzojë caktimin e kandidatit nëse kryeprokurori përkatës ka dështuar të marrë parasysh kërkesat sipas nenit 3 dhe do të kërkojë nga ai të dorëzojë kandidaturën tjetër.
9. KPK-ja, sipas detyrës zyrtare apo me propozimin e kryeprokurorit përkatës, mund të heqë nga pozita ushtruesin e detyrës së udhëheqësit të departamentit përkatës nëse ngrihen çështje lidhur me performancën e tij apo për arsye të tjera që e bëjnë të papërshtatshëm për atë pozitë.

KAPITULLI III PERFUNDIMI I MANDATIT

Neni 23 Përfundimi i mandatit

1. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit dhe Zëvendësit të tij, Kryeprokurorit dhe Zëvendësit të tij dhe Udhëheqësit të Departamentit, përveç në mënyrë të rregullt, përfundon edhe për këto shkaqe:
 - 1.1. dorëheqje;
 - 1.2. shkarkim;
 - 1.3. vdekje;
 - 1.4. arritje e moshës së pensionimit dhe
 - 1.5. kur dënohet për vepër penale, përjashtimisht veprave penale të kryera nga pakujdesia.

2. Përveç sipas paragrafit 1 të këtij neni, mandati i Kryeprokurorit të Shtetit dhe Zëvendësit të tij, Kryeprokurorit dhe Zëvendësit të tij dhe Udhëheqësit të Departamentit, përveç në mënyrë të rregullt, përfundon edhe për këto shkaqe:
 - 2.1. kur dështon në përmbushjen e detyrave të përcaktuara me ligj;
 - 2.2. kur vlerësimi i performancës nga ana e KVPP-së është i pamjaftueshëm;
 - 2.3. kur nuk i zbaton udhëzimet e përgjithshme dhe vendimet e Kryeprokurorit të Shtetit dhe KPK-së dhe
 - 2.4. për shkak të keqmenaxhimit.

3. Kryeprokurori i Shtetit dhe Zëvendësi i tij, Kryeprokurori dhe Zëvendësi i tij dhe Udhëheqësi i Departamentit do të vazhdojnë punën pas përfundimit të mandatit në pozitën e prokurorit në prokurorinë ku kanë shërbyer, respektivisht, pas përfundimit të mandatit të Kryeprokurorit të Shtetit do të vazhdojë punën si prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 24 Procedura për përfundimin e parakohshëm të mandatit

1. KPK-ja shkarkon kryeprokurorin përkatës sipas detyrës zyrtare apo bazuar në propozimin e KPSH-së, nëse plotësohet ndonjë nga kushtet e përcaktuara në nenin 23 të kësaj rregulloreje.

2. Kryeprokurori i Shtetit mund t'ia propozojë KPK-së shkarkimin e kryeprokurorit përkatës sipas kushteve të përcaktuara me nenin 23. Propozimi paraqitet në formë të shkruar me arsyetimin përkatës.
3. Kryeprokurori për të cilin është paraqitur propozimi për shkarkim ftohet për t'u deklaruar para KPK-së.
4. Vendimin për shkarkim nga pozita e merr KPK-ja me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.
5. Dispozitat nga ky nen aplikohen *mutatis mutandis* edhe në rastin e propozimit për përfundim të parakohshëm të mandatit të KPSH-së. Në këtë rast propozimi i dërgohet Presidentit.
6. Në rastet kur arsyeja për shkarkim paraqet shkelje disiplinore aplikohen dispozitat e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

KAPITULLI IV

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE

Neni 25

Dispozitat kalimtare

Me hyrjen ne fuqi të kësaj rregulloreje, KPK-ja obligohet që brenda 30 ditëve të nxjerrë udhëzuesin për Komisionin për vlerësim.

Neni 26

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo rregullore në përbërjen e saj ka shtojcat në vijim:
 - 1.1. Formularin për aplikim;
 - 1.2. Formularin për vetëvlerësimin;
 - 1.3. Formulari i konceptdokumentit të kandidatit për KPSH;
 - 1.4. Formulari i konceptdokumentit të kandidatit për Kryeprokuror dhe
 - 1.5. Formulari i vlerësimit të përgjithshëm të kandidatit.

Neni 27

Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për kriteret dhe Procedurën e nominimit dhe propozimit për emërim të Kryeprokurorit të Shtetit, Rregullorja nr. 08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorëve dhe Rregullorja nr.01/2019

për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr.08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorëve.

2. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshilli Prokurorial i Kosovës

Forma numër 1

FORMULARI PËR APLIKIM

Procedurë e aplikimit	
Nr. i regjistrimit	Data

1. Të dhënat personale			
Mbiemri		Emri	[] Mashkull [] Femër
Adresa e tashme:			
2. Informata lidhur me disa të afërt			
3.1 A është ndonjëri nga të afërmit tuaj pjesëtar i KPK-së? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
3.2 A është ndonjëri nga të afërmit tuaj i punësuar në KPK apo në Prokurorinë e Shtetit? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Nëse përgjigja ndaj ndonjëres nga pyetjet më lart është "Po", atëherë jepni të dhënat si në vijim:			
Emri	Marrëdhënia	Institucioni dhe pozita	
3. A keni jetuar jashtë Kosovës gjatë 20 vjetëve të fundit? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Shënoni të gjitha vendet jashtë Kosovës, në të cilat keni jetuar gjatë 20 vjetëve të fundit, duke filluar nga vendbanimi i tashëm (duke përjashtuar qëndrimet për arsye të udhëtimit dhe festave)			
Qyteti / Fshati:			
Adresa / Rruga :			
prej (muaji/viti):			
deri (muaji/viti):			
Qyteti / Fshati:			
Adresa / Rruga:			
prej (muaji/viti):			
deri (muaji/viti):			
4. Anëtarësia në parti politike			
A keni qenë ndonjëherë anëtar i ndonjë subjekti politik? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Nëse PO shënoni periudhën kohore _____ deri _____			
Subjekti politik _____			
Nënshkrimi: _____ Data: _____			
5. Ankesat ndaj jush			
Kjo pjesë ka tetë pyetje. Përgjigjuni në secilën pyetje me "PO" ose "JO". Për çdo përgjigje "PO" ofroni informacionin e kërkuar.			
5.1. A është paraqitur ndonjëherë ankesë ndaj jush në ndonjë organ disiplinor? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			

Data e ankesës			
Paraqitur në		Emri i ankuesit	
<i>Përshkruaj:</i>			
A keni qenë të informuar lidhur me paraqitjen e ankesës? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
1.2 A është zhvilluar ndonjëherë hetim disiplinor ndaj jush si rezultat i ndonjë ankese? YES <input type="checkbox"/> NO <input type="checkbox"/>			
Data e nisjes së hetimit			
Hetimet u zhvilluan nga (emri i institucionit)			
A keni qenë i njoftuar lidhur me nisjen e hetimeve? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
1.3 Si rezultat i këtij hetimi, a është rekomanduar ndonjë masë disiplinore? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Data e rekomandimit			
Autoriteti rekomandues			
Përmbajtja e rekomandimit			
1.4 Përshkruani hapat e ndërmarrë nga ana e organit përkatës në lidhje me rekomandimin:			
1.5 A ju është shqiptuar ndonjëherë ndonjë masë disiplinore si rezultat i rekomandimit? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Masa sanksionuese			
Shqiptuar nga		Data e sanksionimit	
A keni qenë të informuar lidhur me masën sanksionuese? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Data e njoftimit:		Njoftimi është bërë nga:	
1.6 A është zbatuar masa disiplinore ? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			

Data e fillimit të zbatimit të masës sanksionuese/kohëzgjatja			
Nëse jo , përshkruani arsytet pse:			
1.7 A ju është shqiptuar ndonjëherë masa për suspendim të përkohshëm? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Kërkesa për suspendim ishte bërë nga:			
Autoriteti i ngarkuar me shqiptimin e masës së suspendimit		Data e vendimit	
Kohëzgjatja e suspendimit			
1.8 Jepni informata shtesë që ndërlidhën me pjesën nr. 5 të këtij formulari, për të cilat ju mendoni se janë të rëndësishme për t'u adresuar gjatë procesit të shqyrtimit të aplikacionit tuaj			

7. Çështje penale dhe civile			
Kjo pjesë ka njëmbëdhjetë pyetje. Përgjigjuni në çdo pyetje me "PO" ose "JO". Për çdo përgjigje "PO" ju lutemi jepni informatat e kërkuara.			
6.1.A jeni hetuar ndonjëherë për ndonjë veprë penale? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Data kur kanë nisur hetimet		Data kur kanë përfunduar hetimet	
Hetimet u zhvilluan nga (institucioni)			
Qyteti ku ishin zhvilluar hetimet		Shteti	
Lloji i veprës penale:			

6.2.A keni qenë ndonjëherë i arrestuar apo i dyshuar për aktivitet kriminal?					
PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>					
Data e arrestimit		Qyteti		Shteti	
I arrestuar nga (institucioni)					
Arsyeja e arrestimit:					
6.3.A keni qenë i akuzuar ndonjëherë për vepër penale?					
PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>					
Data e ushtrimit të aktakuzës					
Vendi i ushtrimit të aktakuzës		Shteti			
I akuzuar për					
Përshkruani rastin shkurtimisht:					
6.4.A jeni gjykuar ndonjëherë për vepër penale?					
PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>					
Data e dënimit		Gjykata			
Qyteti		Shteti			
I dënuar për					
Natyra e vendimit të gjykatës (përshkruani vendimin):					

6.5. Nëse kundër vendimit të Gjykatës të Shkallës së Parë është ushtruar ankesë me mjete të rregullta juridike, ju lutemi plotësoni informacionin e kërkuar në vijim.

Data e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Dytë		Gjykata e Shkallës së Dytë	
Qyteti		Shteti	

1.6 Nëse vendimi është kundërshtuar me anë të mjeteve të rregullta juridike, ju lutemi jepni të gjitha detajet?

--

1.7 Nëse është shqiptuar ndonjë sanksion nga gjykata, a është zbatuar ajo?

PO JO

1.8 A keni marrë pjesë ndonjëherë në cilësinë e paditësit apo të paditurit në gjykatë civile apo ekonomike (duke përjashtuar rastet e shkurorëzimit)? PO JO

Data e procesit gjyqësor		Gjykata	
--------------------------	--	---------	--

Përshkrimi i procesit gjyqësor:

--

1.9 Nëse kundër vendimit është ushtruar ankesë me mjete të rregullta ose të jashtëzakonshme juridike, ju lutemi jepni të gjitha detajet?

--

1.10 A keni vepruar ndonjëherë në cilësinë e debitorit në ndonjë procedurë apo të kreditorit në procedurë të ekzekutimit? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Data kur është ushtruar padia për ekzekutim			
Qyteti		Shteti	
Gjykata			
Përshkrimi i padisë:			
1.11 A keni qenë ndonjëherë objekt i procedurës kundërvajtëse me përjashtim të gjobave në komunikacion? PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Përshkruani natyrën e rastit dhe vendimin e Gjykatës:			
2. GJUHA PËR INTERVISTË			
Dëshiroj të intervistohem në:			
<input type="checkbox"/> Gjuhën shqipe			
<input type="checkbox"/> Gjuhën serbe			
3. REFERENCA (emrat dhe kontaktet për tri referenca, duke përjashtuar familjarët dhe të afërmit)			
1.			
2.			

3.

Autorizimi për kërkimin dhe dhënien e informatave personale

Me anë të nënshkrimit tim:

- Unë e autorizoj KPK-në që të marrë informata për mua nga organet e shënuara më poshtë
- Unë i autorizoj organet e shënuara më poshtë që t'i ofrojnë KPK-së informatat e mia personale
- Këto organe janë:
- Policia e Kosovës
- Gjykatat e Kosovës
- Prokuroritë
- Organet përkatëse në shtetet e tjera që mbajnë shënime të hetimeve penale dhe dënimeve
- Agjencia Kundër Korrupsionit.

Data:

Nënshkrimi:

Deklarimi dhe konfirmimi

Me anë të nënshkrimit tim, unë deklaroj se:

- Informatat në këtë formular aplikimi dhe në formularin për vetëvlerësim dhe informatat e përfshira në shtojcat e këtij formulari për emërim si prokuror janë të vërteta dhe të sakta, si dhe janë bërë nën përgjegjësinë për deklaram të rrejshëm.
- E autorizoj Këshillin Prokurorial të Kosovës për t'i verifikuar këto informata.
- Jam i vetëdijshëm se për çdo deklaram të rrejshëm në këtë formular aplikimi unë do ta humb të drejtën e emërimit në pozitë.
- Jam i vetëdijshëm se për çdo deklaram të rrejshëm në këtë formular aplikimi apo formularin e vetëvlerësimit, i cili do të zbulohet pas emërimit tim, menjëherë mund të jem objekt i procedurës disiplinore dhe të rekomandohem për shkarkim nga pozita e emëruar.

Data:

Nënshkrimi: _____

Forma numër 2

FORMULAR I VETËVLERËSIMIT

Të dhëna personale

<u>Mbiemri</u>		<u>Emri</u>		[] Mashkull [] Femër
<p>Kualifikimet dhe aftësitë - Vetëvlerësim</p> <p>Vetëvlerësimi përbën një pjesë të rëndësishme të aplikacionit tuaj dhe ju lejon që të paraqitni shembuj se si ju keni demonstruar cilësitë dhe aftësitë nga përvoja juaj e mëparshme. Ju mund të paraqitni shembuj jashtë punës suaj në Prokurorinë e Shtetit, duke përfshirë edhe përvojën tuaj nga jeta personale.</p> <p>Vetëvlerësimi nuk duhet thjesht të jetë përsëritje e historikut të punës suaj. Ju lutemi të jeni konciz, përgjigjuni në çdo tregues, meqë kufizimi i paraparë për çdo katrorë është prej 250 - 500 fjalë. Formulari për shënime (pika) është i pranueshëm dhe ju lutemi të përdorni vetëm fontin Book Antiqua 12.</p> <p>Ju lutemi të jepni shembuj specifikë, të cilët demonstrojnë se si mund të maten shkathtësitë tuaja me cilësitë dhe aftësitë e kërkuara të nivelit të përshtatshëm për pozitën që aplikoni.</p> <p>Nuk mjafton të shkruani në mënyrë të përgjithshme lidhur një situatë dhe çfarë ka ndodhur, ne dëshirojmë ta dimë konkretisht se çfarë keni menduar, cilat veprime i keni ndërmarrë, si e keni trajtuar situatën dhe rezultatin.</p>				
<p>Aftësitë udhëheqëse dhe menaxheriale</p>				
<p><u>Treguesit (pyetjet):</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Aftësi për të identifikuar problemet sistemore ose dobësitë dhe për të ndërmarrë veprim të përshtatshëm për zgjidhjen e tyre. • Aftësi për të formësuar objektiva afatgjata për institucionin në bashkëpunim dhe konsultim me të tjerët. • Aftësi për të zhvilluar dhe mbajtur komunikim të efektshëm me institucionet relevante që janë brenda dhe jashtë sistemit të drejtësisë. • Aftësi për të kuptuar marrëdhëniet e jashtme të Prokurorit të Shtetit dhe për të drejtuar dhe balancuar me kategorinë e presioneve politike, nacionale dhe ndërkombëtare. • Aftësi për të siguruar adresimin e objektivave dhe nevojave të Prokurorit të Shtetit. 				

- Aftësi për të komunikuar në mënyrë të efektshme dhe pozitive me mediat.
- Aftësi për të caktuar rolin e Prokurorit të Shtetit në ofrimin e shërbimeve për publikun;
- Aftësi për të planifikuar dhe organizuar punën brenda institucionit dhe për të siguruar që Prokurori i Shtetit të arrijë rezultate.
- Aftësi për të deleguar dhe për të zhvilluar strukturat menaxheriale dhe organizative.
- Aftësi për të kuptuar dhe për të përdorur një spektër të gjerë të menaxhimit të informacionit (p.sh: buxhetet financiare, statistikat e performancës) në mënyrë kompetente dhe të veprojë në bazë të asaj se çfarë tregojnë ato.
- Aftësi për të promovuar aspekte profesionale të menaxhimit dhe për të zhvilluar teknika të reja për të pasur përmirësim të rezultateve.
- Aftësi për të krijuar një kulturë të fleksibilitetit dhe të reagimit, për të mobilizuar të tjerët për të reaguar shpejt ndaj ndryshimit të nevojave dhe prioriteteve dhe duke siguruar që rëndësia e arritjes së objektivave të komunikohet dhe të kuptohet nga tërë stafi.
- Aftësi për të analizuar arsyet e dështimit dhe për të siguruar ndërmarrjen e veprimeve konkrete nga mësimet e nxjerra.
- Kërkon mundësi për inovacion dhe ka inkurajon mënyrat për kryerjen e punëve.

Njohuri dhe përvojë praktike nga sistemi i drejtësisë penale (duke përfshirë çështjet relevante të të drejtave të njeriut)

Treguesit (pyetjet):

- Kupton rolin e Prokurorit të Shtetit brenda sistemit të gjithmbarshëm të drejtësisë penale (duke përfshirë përgjegjësitë e përbashkëta të institucioneve penale të drejtësisë dhe bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërmjet institucioneve).
- Ka njohuri kredibile për ligjin dhe sistemin e drejtësisë penale, duke përfshirë edhe çështjet relevante të të drejtave të njeriut.
- Kaq aftësi për të ndikuar pozitivisht, këshilluar dhe udhëzuar prokurorët lidhur me ligjin dhe procedurat.
- Demonstron të arriturat e punës së tij/saj praktike në sistemin e drejtësisë penale;
- Demonstron aftësinë e përfaqësimit efektiv të aktakuzës në gjykatë.

- Çfarëdo rasti kur kanë ardhur në shprehje aftësitë profesionale dhe kreativiteti në trajtimin e një çështjeje penale komplekse apo të ndjeshme, e cila ka rezultuar me përfundimin e suksesshëm të asaj çështjeje.
- Posedon vetiniciativa në adresimin e çështjeve konkrete.

Puna ekipore dhe menaxhimi i stafit

Treguesit (pyetjet):

- Aftësi për të ndërtuar dhe mirëmbajtur raporte pozitive me të tjerët brenda Prokurorisë së Shtetit dhe për të vlerësuar mendimet dhe punën e të tjerëve brenda Prokurorisë së Shtetit.
- Aftësi për të komunikuar në mënyrë të efektshme brenda Prokurorisë së Shtetit.
- Aftësinë për të ruajtur mbështetjen dhe përkushtimin e të tjerëve për ndryshime dhe është në gjendje të marrë vendime edhe nëse ato janë të pafavorshme për individë.
- Aftësi për të promovuar përmirësim të vazhdueshëm të performancës, duke ndihmuar edhe te tjerët për të identifikuar dhe zgjidhur problemet.
- Aftësi për të siguruar zhvillimin e shkathtësive profesionale dhe të njohurive për stafin me qëllim të avancimit të performancës dhe të profesionalizmit.
- Aftësi për të menaxhuar individët dhe zyrat me konsistencë, profesionalizëm, objektivitet dhe në mënyrë të drejtë dhe për të krijuar një mjedis të mirë për punë për tërë stafin.
- Njeh dhe shpërblen performancën e mirë dhe adreson performancën e dobët.

<u>Aftësitë teknologjike</u>
Treguesit (pyetjet):
<ul style="list-style-type: none"> • Përshtatja me teknologjitë e reja • Njohja e SMIL-it. • Aftësi për përdorimin e teknologjisë gjate ndjekjes penale te rasteve.

Unë: _____ (emri, mbiemri), deklaroj me bindje të plotë se këtë vetëvlerësim e kam plotësuar vetë dhe se përmbajtja e tij është e saktë.

Nënshkrimi: _____

Data: _____

FORMULARI NUMËR 3

KONCEPTDOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR TË SHETITIT

Mbiemri:	
Emri:	

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni:

I. Analizën tuaj, si vijon:

1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?

2. Cilat mendoni se janë përparësitë kryesore të Prokurorisë së Shtetit?
3. Cilat janë mangësitë kryesore të Prokurorit të Shtetit?
4. Cilat janë rreziqet, sfidat dhe/apo mundësitë e veçanta?

II. Vizioni juaj për përmirësimin e punës operative në Prokurorinë e Shtetit

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjate:

1. Cili është vizioni juaj për Prokurorin e Shtetit gjatë mandatit tuaj?
2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?
3. Cilat janë vështirësitë apo rreziqet që prisni gjatë përmbushjes së këtyre objektiveve?
4. Si do t'i tejkalojnë ato?

III. Vizioni për të menaxhuar personelin në sistemin prokurorial

Ju lutem renditni hapat konkretë që do t'i ndërmerrni gjatë mandatit tuaj?

1. Cilat janë metodat dhe mënyrat tuaja për menaxhimin e stafit?
2. Si planifikoni të ndërtoni një sistem të zhvillimit në karrierë për stafin?
3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit?

IV. Hapat që do të ndërmerrni për përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënies së sistemit dhe besimit të publikut?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Përvoja juaj e deritashme?
2. Hapat që do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë së sistemit prokurorial, duke vënë një baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?
3. Çfarë planifikoni të ndërmerrni për të siguruar një punë cilësore të prokurorëve?
4. Çfarë planifikoni të përmirësoni në llogaridhënien e përgjithshme të sistemit?

Konceptdokumenti nuk duhet të përmbajë më shumë se 15 faqe me shkrimin e llojit Book Antiqua, madhësia 12, hapësira njëshe.

Deklaroj se përmbajtjen e këtij konceptdokumenti e kam përgatitur vetë dhe jam në dijeni se Konceptdokumenti i Kryeprokurorit të Shtetit të emëruar do të publikohet në uebportal.

Nënshkrimi: _____

Datë: _____

FORMULARI NUMËR 4
KONCEPTDOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR

Mbiemri:	
Emri:	

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni:

I. Analizën tuaj, si vijon:

1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?
2. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në prokurorinë për të cilën keni aplikuar?

3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?
4. A mendoni se strategjitë aktuale të sistemit adresojnë nevojat e prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?

II. Vizioni juaj për përmirësimin e punës operative në prokurorinë që keni aplikuar?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?
2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?
3. Cilat janë vështirësitë që prisni gjatë përmbushjes së këtyre objektivave?
4. Si do t'i tejkalonit ato?

III. Vizioni për të menaxhuar personelin në sistemin prokurorial

Ju lutem renditni hapat konkretë që do t'i ndërmerrnit gjatë mandatit tuaj:

1. Cili është modeli juaj në menaxhimin e stafit?
2. Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin?
3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit?

IV. Hapat që do të ndërmerrni për përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënies se prokurorisë **sistemit dhe besimit të publikut?**

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Hapat që do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj, duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?
2. Çfarë planifikoni të ndërmerrni për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?
3. Çfarë planifikoni të përmirësoni në llogaridhënien e përgjithshme në Prokurorinë tuaj?

Konceptdokumenti nuk duhet të përmbajë më shumë se 10 faqe me shkrimin e llojit Book Antiqua, madhësia 12, hapësira njëshe.

Deklaroj se përmbajtjen e këtij konceptdokumenti e kam përgatitur vetë dhe jam në dijeni se pas emërimit, i njëjti do të publikohet në uebportal.

Nënshkrimi: _____

Datë: _____

FORMULARI NUMËR 5

Formulari i vlerësimit të përgjithshëm të kandidatit

Emri dhe mbiemri i kandidatit: _____

ANËTARI	KONCEPTDOKUMENTI	INTEGRITETI	AFTESITË MENAXHERIALE DHE UDHËHEQËSE	NJOHURITË TEKNOLOGJIKE DHE PËRVOJA E NEVOJSHME PËR POZITËN
A				
B				
C				
D				
E				